



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE  
EKONOMISË

Nr. 5840 Prot. datë 30.3.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

Nr. 1874 Prot. datë 30.3.2021

**URDHËR I PËRBASHKËT**

Nr. 64, datë 30.3.2021

**PËR NGRITJEN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT SEKTORIAL TË  
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 11 të ligjit nr. 10 247, datë 4.3.2010, "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve", të ndryshuar, të vendimit nr. 426, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e organizimit, të funksionimit, si dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteteve sektoriale dhe mënyrën e shpërblimit të tyre", ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional dhe ministri përgjegjës për arsimin,

**URDHËROJNË:**

1. Ngritjen e Komitetit Sektorial të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).
2. Komiteti Sektorial TIK, organizohet në formën e grupit teknik dhe ka në përbërje 10 (dhjetë) anëtarë si më poshtë:
  - a) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;
  - b) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional;
  - c) një përfaqësues nga ministria/institucioni përgjegjës për sektorin e TIK;
  - ç) një përfaqësues nga shoqatat e punëdhënësve të sektorit të TIK, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;
  - d) një përfaqësues nga shoqatat e punëmarrësve që mbulojnë sektorin TIK, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;
  - dh) një përfaqësues nga institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional (AFP) të sektorit TIK, me numrin më të madh të nxënësve/kursantëve në sektorin përkatës;

- e) një përfaqësues të biznesit me praktika të pasura në zhvillimin e burimeve njerëzore në sektorin TIK;
- ë) tre ekspertë të pavarur, me përvojë jo më pak se 5 (pesë) vjet në zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).
3. Kryetari zgjidhet në mbledhjen e parë të komitetit dhe, si rregull, duhet të jetë anëtari me më shumë eksperiencë në çështjet e TIK dhe në zhvillimin e zbatimit të KSHK-së.
4. Ngarkohen ministritë përgjegjëse respektive për caktimin e anëtarëve të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “dh” të pikës 2 të këtij urdhri, në bazë të kriterëve të parashikuara në vendimin nr. 426, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, dhe përcjelljen e tyre Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), jo më vonë se 1 (një) muaj nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
5. Ngarkohet AKAFPK për përzgjedhjen e anëtarëve të parashikuar në shkronjat “ç”, “d”, “e” dhe “ë”, të pikës 2 të këtij urdhri, si dhe titullari i saj për ngritjen e sekretariatit teknik, brenda 1 (një) muaj nga hyrja e tij në fuqi.
6. Ngarkohen ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, ministria përgjegjëse për arsimin, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe Komiteti Sektorial i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR



ANILA DENAJ



MINISTËR



EVIS KUSHI

